



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2021:144838

Datë: 09.08.2024

Numri i dokumentit: 06035318

**C.nr.599/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm**, në përbërje prej gjyqtarit Zenel Tasholli, gjyqtar individual, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Sh. G. nga L..., V..R. nga fsh.B..i M.. K.L., S.. K.. nga fsh.G...K.L..., H.. S.. nga fsh.B.. K.L.. dhe Y.Th.nga L... të cilat me autorizim i përfaqëson Marigona Gashi av në Lipjan, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Lipjan, me objekt kontesti kompensim i të ardhurave në bazë të kualifikimit, jashtë seance gjyqësore, me dt.11.07.2024 merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**I.APROVOHET** në tërsi kërkesëpadia e paditësve Sh. G. nga L..., V..R. nga fsh.B..i M.. K.L., S.. K.. nga fsh.G...K.L..., H.. S.. nga fsh.B.. K.L.. dhe Y.Th.nga L... ani si e bazuar, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Lipjanit-DKA, që paditëseve të më poshtë shënuara t'ua paguajë dhe atë:

**1.Paditëses Sh.G.. nga L..** në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për kualifikim fakulteti bachelor, për periudhën nga data 06.07.2018-31.01.2023, t'ia paguajë 27% të pagës bazë- shumën prej **3,525.50€** me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë dt.06.07.2021 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

**2.Paditëses V.. R.nga fsh.B.. i M..**, në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për kualifikim, për periudhën nga data 06.07.2018-31.01.2023, t'ia paguajë shumën prej **3,204.85€** me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë dt.06.07.2021

e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

3. **Paditëses S..K..nga fsh.G.. K.L...**, në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për kualifikim-faulteti master, për periudhën nga data 06.07.2018-31.01.2023, t'ia paguajë 35% të pagës bazë-shumën prej **4,896.65€** me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë dt.06.07.2021 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

4. **Paditëses H.. S..nga fsh.B.. K.L...**, në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për kualifikim fakulteti master, për periudhën nga data 06.07.2018-31.01.2023, t'ia paguajë 35% të pagës bazë- shumën prej **4,896.65€** me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë dt.06.07.2021 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

5. **Paditëses Y..Th..nga L...**, në emër të kompensimit shtesë të të ardhurave personale për kualifikim-fakulteti master, për periudhën nga data 06.07.2018-31.01.2023, t'ia paguajë 35% të pagës bazë-shumën prej **4,896.65€** me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë dt.06.07.2021 e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. Detyrohet e paditura që paditësve t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë 1,348.00 €, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

## **A r s y e t i m**

E autorizuar e paditësve, me datë 06.07.2021 në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i diferencës në shtesë në pagë në emër të kualifikimit Me padi, ka theksuar se paditëset janë të punësuar si mësimdhënës enë ShFMU”I.K..” “ në fsh.S... ku edhe vazhdojnë të punojnë edhe sot.

Me parashtrësën për precizim te dt.09.07.2024 ka theksuar se sa i përket kërkeses për kompensim në emër të kualifikimit paditëset janë me diplomë fakulteti për të cilin fakt i takon shtesa e të ardhurave personale 27 % përkatsisht 35% e pagës bazë në muaj edhe atë, në përputhje me Ligjin e Punës dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK), ndërsa e paditura i ka paguar atë vetëm pjesërisht duke i mbetur borxh për pjesën tjetër, dhe ate për periudhen nga dt.06.07.2018-31.01.2023 paditëses Sh..G..shumen prej 3.525.50€, paditëses V..R.. shumen prej 3,204.85€, paditëses S.. K..shumen prej 4,896.65€, paditëses H.. S.. shumen prej 4,896.65€ dhe

paditeses Y.. Th.. shumen prej 4,896.65€. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, përkatësisht shumën 624.00 €, për taksën gjyqësore për padi sa do të caktohet nga gjykata.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi. E paditura përmes përgjigjes së saj në padi të parashtruar me datë 24.02.2023 e ka kundërshtuar bazën juridike të kerkespadiisë dhe se sipas nenit 90 pika 5 të Ligjit 03/L212 të Punës në të cilën thirret paditësi, ku thuhet se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditëses nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje-kontratës kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Poashtu nëse merret parasysh Kontrata Kolektive në nenin 46 par.2 shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e që konsideron se nuk janë plotësuar këto kushte, sepse të paditues nuk i janë ndarë mjete financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive. Poashtu sa i përket inflacionit është kompetencë e nivelit qendror e poashtu pika 10 e nenit 35 të Kontratës Kolektive nuk e qartëson se nga kush bëhet përcjellja dhe kush e bënë kompensimin për inflacion. I ka propozuar gjykatës që konform dispozitave ligjore të LK-së nenit 399 par.1 dhe 2 padinë e paditësit ta refuzon si të pabazuar-e pathemeltë.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, poashtu ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese, se paditëset janë mësimdhënës të kualifikuar me fakultet me titull bachelor dhe master, paga bazë për paditëset është në shumë prej 421.00€, ndërsa nga e paditura janë kompensuar vetëm pjesërisht, fakte këto të mbështetura kontrata e punës për paditësen Shqipe Gjoci nr. prot.04-112-813-..dt.01.09.2020 dhe diploma e lëshuar nga Universitetit i Prishtinës”Hasan Prishtina” me nr.629 dt.07.07.2011 me titull profesor i kulturës fizike, kontrata e punës nr. prot.04-112-813-3066 e dt.01.09.2020 paditësen Y.. Th..dhe diploma e lëshuar nga Universitetit i Prishtinës”Hasan Prishtina” me nr....me titull master i pedagogjisë, nga kontrata e punës e paditëses Hanumshah Salihu nr.04-112-... dt.01.09.2017 dhe diploma e lëshuar nga Kolegji AAB me nr... dt.06.10.2017 me titull master i gjuhës angleze, nga kontrata e punës e paditëses S..K..nr.04-112-... dt.01.09.2022 dhe diploma e lëshuar nga Universitetit i Prishtinës”H.P..” me nr.2 me titull master i pedagogjisë, nga kontrata e punës e paditëses V..R.. nr.04-112-813... dt.01.09.2017, dhe dhe diploma e lëshuar nga Universitetit i Prishtinës”Hasan Prishtina” me nr.1035 dt.14.05.2015 me titull bachelor i pedagogjisë dhe nga lista e pagave nga Buxheti i Kosovës në emër të paditësve, prova këto vendimtare për vendosje në këtë çështje kontestimore, pasi janë lëshuar nga organi kompetent, këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës, duke

provuar kështu saktësinë e thënieve në këto dokumente, ashtu siç është paraparë në nenin 329.1 të LPK-së.

Duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare e as gjendjen faktike por vetëm bazën e kërkesëpadiisë, gjykata ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadiisë së paditësit, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del e mbështetur në dispozitat e nenit 55. 1 të Ligjit të Punës që përcakton se: “I punësuari ka të drejtë në pagë e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90. 5 i cili ka përcaktuar: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”, lidhur me dispozitat e KKKAK-së së datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, përkatësisht neni 3. 2 i cili ka përcaktuar se: “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratën Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”. Në Vendimin e Qeverisë nr. 01/33, të datës 29.08.2008, në fuqi deri me datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik nr. 08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësit, drejtorët, zëvendës drejtorët dhe bashkëpunorët profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike 19 %, me diplomë universitare 3 dhe 4 vjeçar 27 % dhe me diplomë të 5 vjeçare, master dhe doktoraturë 35 % të pagës bazë. Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit licencimit, është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 214/2023, të datës 05.10.2023.

Në këtë çështje kontestimore, gjykata vlerësoi se e paditura nuk ia ka kompensuar paditëseve pagën sipas përqindjes për shkak të kualifikimit shkollor sepse i ka paguar vetëm pjesërisht, dhe atë paditëses Sh..G..me kualifikim bachelor - 27% e pages bazë i ka paguar pjesërisht shumën mujore prej 49.57€ ndërsa i ka mbetur borxh në shumen mujore prej 64.10€, e gjithsej për 55 muaj në shumë të përgjithshme prej 3,525.50€, paditëses V..R.. i ka paguar pjesërisht shumën mujore prej 55.40€ ndërsa i ka mbetur borxh në shumen mujore prej 58.27€, e gjithsej për 55 muaj në shumë të përgjithshme prej 3,204.85€, paditëses S..K.. me kualifikim master aspo 35 % e pages bazë i ka paguar pjesërisht shumën mujore prej 58.32€ ndërsa i ka mbetur borxh në shumen mujore prej 89.03€, e gjithsej për 55 muaj në shumë të përgjithshme prej 4,896.65, paditëses H.. S..me kualifikim master aspo 35 % e pages bazë i ka paguar pjesërisht shumën mujore prej 58.32€ ndërsa i ka mbetur borxh në shumen mujore prej 89.03€, e gjithsej për 55 muaj në shumë të përgjithshme prej 4,896.65€ dhe paditëses Y.. Th..me

kualifikim master aspo 35 % e pages bazë i ka paguar pjesërisht shumën mujore prej 58.32€ ndërsa i ka mbetur borxh në shumen mujore prej 89.03€, e gjithsej për 55 muaj në shumë të përgjithshme prej 4,896.65, pasi sipas përqindjes së përcaktuar në Vendimin e Qeverisë është dashur të paguhen 27% përkatsisht 35% të pagës bazë mvarësisht prej kualifikimit, e për këtë arsye e detyroi të paditurën si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës lidhur me faktin e zbatimit ose jo të kontratës kolektive, gjykata i gjeti të pa bazuara këto pretendime, pasi në rastin konkret baza juridike e kërkesës së paditësit buron nga Vendimi i Qeverisë. Edhe pretendimin se paditësja është pranuar në punë sipas këtij kualifikimi dhe në kontratën e saj të punës përcaktohen përqindjet sipas kualifikimit, për gjykatën ishte fakt jo relevant për këtë çështje kontestuese pasi përqindjet sipas kriterëve të licencimit të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë dhe në kontratë të punës kanë dallim mes vete dhe mësimdhënësit nuk kompensohen sipas këtyre kriterëve. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore të palës së paditur se nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në procedurë dhe se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk e obligon të paditurën, por nivelin e pushtetit qendor, pasi që vlerëson se referuar dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, rrjedhë se obligimi për përmbushjen e të drejtave të punësuarve të parapara me këtë kontratë, i takojnë pikërisht punëdhënësit, që në rastin konkret i bie të jetë e paditura, andaj edhe ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë e paditur në procedurën konkrete kontestimore dhe në këtë pikëpamje, çfarëdo vështirësie që i atribuohet implikimeve financiare lidhur me zbatimin e kësaj kontrate, nuk e liron të paditurën nga përgjegjësia për përmbushjen e obligimit në raport me kërkesën e paditësve, gjegjësisht nuk paraqet bazë që kërkesëpadia të trajtohet si e pa themeltë.

Gjykata për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382paragrafi 2 i LMD-s, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga dita e paraqitjes së kërkesëpadisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në nenin 449 lidhur me nenin 452.1 dhe 463.1 të LPK-së, pasi e paditura e ka humbur kontestin dhe për këtë arsye u detyrua të paguajë shpenzimet e paditëses edhe atë, për përpilimin e padisë shumën prej 624 €, për precizimin e kërkesëpadisë shumën prej 624.00€ dhe për taksën gjyqësore për padi shumën 100.00 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**

**C.nr. 599/2021 me datën 11.07.2024**

**Gj y q t a r i**

**Zenel Tasholli**

**Udhëzim juridik:** Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.